



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 dhjetor 2017
Nr. ref.: AGJ 1178/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI90/16

Parashtrues

Branislav Jokić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të
Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KKPK/D/R/230/2014, të
13 marsit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Branislav Jokić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në Mlladenovc, Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston mospërmbarimin e Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KKPK/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014 (në tekstin e mëtejme: KKPK).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimit të lartcekur të KKPK-së, për shkelje të pretenduara të lirive dhe të drejtave themelore të parashtruesit, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 20 korrik 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj të sjellë dokumente shtesë.
8. Më 19 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
9. Më 30 janar 2017, Gjykata e njoftoi Komunën e Pejës dhe Agjencinë Kosovare të Pronës për regjistrimin e kërkesës dhe ua dërgoi nga një kopje të saj, duke u dhënë mundësinë e dorëzimit të komenteve në Gjykatë.
10. Më 7 shkurt 2017, Agjencia Kosovare e Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) dorëzoi në Gjykatë komentet e saj.

11. Më 5 dhjetor 2017, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe konstatimin për shkelje.
12. Të njëjtën datë, Gjykata njëzëri votoi që kërkesa të deklarohet e pranueshme dhe të konstatohet shkelje.

Përmbledhja e fakteve

13. Komuna e Pejës me Aktvendimin nr. 463-449/97, të 26 majit 1997 kishte vendosur që parashtruesit të kërkesës t'i njihte të drejtën e pronësisë në ngastrën numër 5351/7, në sipërfaqe prej 0.03,52 ha, ZK Pejë.
14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në AKP për vërtetimin e të drejtave të tij të posedimit mbi pronën e lartpërmendur.
15. Me vendimin grupor KPCC/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014, Komisioni i Agjencisë Kosovare të Pronës ka vendosur që:

“(a) Parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se është bartës i të drejtës pronësore Branislav Jokić, pronar 1/1 i pronës në fjalë dhe ka qenë pronar i pronës së shkatërruar në ditën e shkatërrimit të pronës banesore si dhe të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën gjendet e njëjta, ose e ka trashëguar më pas pronësinë e lartcekur;

Dhe ka urdhëruar që:

b) Branislav Jokić e realizon të drejtën e posedimit mbi pronën e cekur;

c) I padituri, nëse ekziston, apo çdo person tjetër i cili shfrytëzon pronën të largohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të këtij urdhri; dhe

d) nëse i padituri, apo çdo person tjetër që e shfrytëzon pronën refuzon t'i bindet këtij urdhri për lirin e pronës në afatin e paraparë, të njëjtit do të largohen nga prona;

Përveç kësaj, Komisioni ka nxjerrë vendimin që:

a) Në lëndët ku ekziston më shumë se një pronar i pronës së çështjes, vendimi dhe urdhri i lartcekur nuk ndikojnë në të drejtat e cilitdo bashkëpronar.

b) Kërkesa për kompensimin e dëmit apo humbja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës në fjalë refuzohet, sepse Komisioni nuk ka kompetencë që t'i zgjedhë kërkesat e tilla.

16. Në arsyetimin e vendimit të lartcekur të KKPK-së, theksohet:

“... paraqitësit e kërkesës ose bartësit e të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, përveç kërkesave me numër 48054 dhe 50686, i kanë plotësuar kushtet për urdhrin në të cilin konfirmohet pronësia mbi pronën e kërkuar

dhe ngastrën e tokës. Në kërkesat me numër 48054 dhe 50686, paraqitësit e kërkesës kanë dëshmuar se i plotësojnë kushtet për urdhrin në të cilin konfirmohet pronësia mbi pronën e kërkuar dhe e drejta e shfrytëzimit të ngastrës së tokës në të cilën gjendej prona në ditën e rrënimit të pronës banesore në fjalë. Fakti se pronat janë shkatërruar nuk ka ndikim në të drejtën e paraqitësit të kërkesës për vendimin e Komisionit në të cilin konfirmohet pronësia e paraqitësit të kërkesës mbi atë pronë në ditën e rrënimit të pronës së kërkuar”.

17. Më 12 janar 2016, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga AKP-ja që t'i kthej në posedim pronën e tij dhe që të bëjë ndryshimet e duhura në regjistrimin e pronës në Kadastrin e Komunës së Pejës, në pajtim me vendimin e formës së prerë dhe detyrues të KKPK-së dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.
18. Më 14 mars 2016, AKP-ja përmes parashtrësës Ref. 00327/16 ndaj të cilës nuk mund të ushtrohet asnjë mjet juridik, e njofton parashtruesin e kërkesës se ajo nuk është në gjendje të ekzekutojë vendimin e KKPK-së, në rastin KPA 48054. Në përgjigje thuhet se AKP-ja ka pranuar nga Drejtoria për çështje pronësore-juridike të Komunës së Pejës Vendimin me nr. 01-463-65203, të 14 majit 2015, në bazë të të cilit është aprovuar nga Kuvendi Komunal propozimi i kësaj drejtorie për të shpallur si akt absolutisht të pavlefshëm vendimin për ndarjen e tokës për shfrytëzim nr. 463-499/97, i 26 majit 1997, dhe njëherësh janë anuluar *ex-tunc* (efekt prapaveprues) të gjitha veprimet faktike dhe juridike të këtij vendimi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës], nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe nenit 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt), nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
20. Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është se vendimi i formës së prerë i KKPK-së, i 13 marsit 2014 nuk është përmbaruar.
21. Parashtruesi i kërkesës deklaron se “*Me vendimin e KKPK-së, KPCC/D/R/230/2014, të 13.03.2014, mua më është njohur e drejta pronësore mbi pronën në fjalë. Kundër atij vendimi nuk është parashtruar ankesë në Kolegjin për ankesa të Gjykatës Supreme. Në këtë kontekst, vendimi i KKPK-së është bërë i plotfuqishëm dhe paraqet çështje të gjykuar.*”
22. Më tej ai thekson se “*Sa i përket ekzekutimit të këtij vendimi, unë i jam drejtuar AKP-së me kërkesë për të ma kthyer posedimin e pronës.*” Sepse “*barra e moszbatimit dhe mosgjetyes së mekanizmave përkatës për zbatimin e këtij vendimi të plotfuqishëm të KKPK-së KPCC/D/R/230/2014, të 13.03.2014, bie mbi AKP-në. Vendimi i organit komunal administrativ nuk duhet të paraqet në asnjë mënyrë arsye për mohimin e të drejtës sime për gëzim të pronës.*”

23. Në fund, ai deklaroi se *“Sa i përket shkeljes së të drejtës për mbrojtje të pronës, vendimi i KKKP-së paraqet pritje legjitime për mua, që kam të drejtë në atë pronë. Prandaj, unë kërkoj të drejtën që në mënyrë paqësore ta gëzoj pronën e lartcekur, siç garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.”*
24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të konstatojë shkelje të lirive dhe të drejtave themelore; të vendosë për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial dhe të urdhërojë Agjencinë Kosovare të Pronës që në afatin më të shkurtër të mundshëm ta ekzekutojë Vendimin e KKKP-së, KPCC/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014.

Përgjigjja e Agjencisë Kosovare të Pronës

25. AKP-ja njoftoi Gjykatën se me Vendimin KPCC/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014 është aprovuar kërkesa e z. Jokić, përmes së cilës është vendosur që atij *“t’i konfirmohet e drejta e pronësisë në pjesën ideale prej 1/1 dhe gjithashtu ishte pronar në ditën e shkatërrimit të pronës të kërkuar banesore dhe të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën gjendej ajo si dhe t’i kthehet e drejta e posedimit të pronës që kërkohej.”*
26. Në vijim, AKP-ja deklaroi se *“me datën 22 tetor 2014, një kopje e Vendimit të Komisionit i është dërguar Komunës së Pejës dhe brenda afatit të paraparë ligjor, Agjencia nuk ka pranuar asnjë Ankesë kundër Vendimit të Komisionit ndërsa me datën 29 prill 2015, Agjencia ka pranuar nga Komuna e Pejës respektivisht nga Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike shkresën e datës 18 mars 2015, Ref. nr. 15-463-LP-324, përmes të cilit Agjencia është njoftuar se lidhur me ngastrën 5351/7, respektivisht pronën e z. Branislav Jokić, është nxjerrë një aktvendim nga Kuvendi Komunal i Pejës përmes të cilit Aktvendimi mbi ndarjen e trojeve në shfrytëzim nr. 463-449/97, është shpallë, akt absolutisht i pavlefshëm.”*
27. Në fund, AKP-ja thekson se moszbatimi i Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/230/2014, i 13 marsit 2014, është rrjedhojë e shpalljes si akt absolutisht i pavlefshëm i vendimit fillestar të kësaj Komune i vitit 1997.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.
29. Sa i përket kërkesave të parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

30. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, ai iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për përmbarimin e Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, përkatësisht Vendimit KPCC/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014.
31. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh se: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.”*
32. Gjykata dëshiron të theksojë se kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit prej 4 (katër) muajve nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimeve nga autoriteti publik. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) thekson në mënyrë eksplicite se në një situatë të ngjashme, që paraqitet në rastin e *Iatridis kundër Greqisë*, rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendimin konkret (shih, *mutatis mutandis*, *Iatridis kundër Greqisë*, nr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 19 tetorit 2000).
33. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
34. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur me mospërmbarimin e vendimit të KKPK-së në rastin e tij.
35. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë në mënyrë legjitime të jetë viktimë e mospërmbarimit të vendimit të KKPK-së.
36. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se është përmbushur kushti i dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe se i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, si dhe i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me realizimin e të drejtave të tij për gëzimin dhe posedimin e pronës.
37. Prandaj, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta deklaruar atë të papranueshme (Shih, për shembull, rasti *A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe nr. 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55, dhe gjithashtu shih *mutatis mutandis* rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016), rrjedhimisht Gjykata konsideron se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim meritore.

Meritat e kërkesës

38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e pronës] të Konventës.
39. Në këto raste, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës në pajtim me nenin 31 në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Sa i përket shkeljes së pretenduar për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

40. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se ekziston një vendim i formës së prerë përmes të cilit është konfirmuar e drejta e tij në pronë. Ai ka tentuar në vazhdimësi ta përmbarojë të njëjtin, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më tani dhe se rrjedhimisht është duke u shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

42. Përveç kësaj, neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, parasheh:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”

43. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, që përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

44. Gjkata vëren se vendimi i KKPK-së është nxjerrë më 13 mars 2014. Ky vendim është bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm më 22 nëntor 2014, për shkak se asnjë palë e interesuar nuk ka ushtruar mjet juridik ndaj këtij vendimi.
45. Gjkata vëren se parashtuesi i është drejtuar me shkrim AKP-së, me kërkesë për përmbarimin e vendimit në rastin e tij. Parashtuesi i kërkesës është përpjekur vazhdimisht që vendimi i formës së prerë në rastin e tij të përmbarohet.
46. Gjkata rikujton praktikën e saj, siç theksohet në rastin KI144/14 dhe KI156/14 sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të Republikës së Kosovës, Gjkata konstaton se AKP-ja është organ i vetëm kompetent për përmbarimin e vendimeve të KKPK-së dhe vendimeve të Kolegjit të Apelit të AKP-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e AKP-së, të cilët morën pjesë si palë në dëgjimin publik, të mbajtur më 10 mars 2014, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin nr. KI187/13.
47. Në rastin konkret, Gjkata vëren se megjithëse vendimi i formës së prerë i KKPK-së është nxjerrë më 13 mars 2014, AKP-ja pohoi se deri te mospërmbarimi i këtij vendimi ka ardhur si shkak i një vendimi tjetër të nxjerrë në procedurë administrative. Konkretisht, Vendimi nr. 01-463-65203, i 14 majit 2015 i Kuvendit Komunal të Pejës.
48. Gjkata rikujton se pavarësia e gjyqtarëve cenohet kur ekzekutivi ndërhyr në një çështje të pazgjidhur përpara gjykatave me qëllim që të ndikojë në rezultatin e atij rasti (shih, Aktgjykimin 25 korrikut 2002, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553/99 dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 26 nëntorit 2002, *Mosteanu and Others v. Romania*, nr. 33176/96).
49. Në rastin konkret, Gjkata vëren se Komuna Pejës e ka përmbytur një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të detyrueshëm përmes një vendimi administrativ; çka bie ndesh, me parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe po ashtu cenon zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjyqësorit.
50. Në lidhje me këtë, Gjkata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës), parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 korrikut 2004, *Romashov kundër Ukrainës*, nr. 67534/01).
51. Gjkata rikujton se vendimet e KKPK-së të formës së prerë janë të detyrueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë dhe nuk i nënshtrohen asnjë rishikimi të jashtëzakonshëm gjyqësor apo administrativ (shih Aktgjykimin e 23 prillit 2012, KI104/10 *Dražić Arsić*, Vlerësimi i

kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, GZ nr. 78/2010, të 7 qershorit 2010).

52. Prandaj, Gjykata konstaton se Vendimi nr. 01-463-65203, i 14 majit 2015, i Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës është i pavlefshëm.
53. Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 19 marsit 1997, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, para. 40). Në rastin konkret, GJEDNJ konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i përmbarimit të vendimit të formës së prerë, që ishte marrë në favor të tyre.
54. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë moszbatimin e vendimeve me qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të rastit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 korrikut 2002, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553, paragrafi 72, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 24 korrikut 2003, *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, paragrafi 52).
55. Autoritetet kompetente e kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 nëntorit 2008, *Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21839/03, *Martinovska kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 22731/02).
56. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila është mënyra më e përshtatshme që AKP-ja, në kuadër të kompetencave që ka, t'i gjejë mekanizmat efikas të natyrës ekzekutive, në kuptim të përmbushjes së plotë të detyrimeve që përcaktohen me ligj dhe Kushtetutë. Megjithatë, çdo individ gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj (shih: nenin 54 të Kushtetutës).
57. Gjykata dëshiron të theksojë se në Aktgjykimin e saj të 16 prillit 2014, në rastin nr. KI187/13, tashmë është marrë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimeve të KKPb-së. Në atë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe të nenit 54 të Kushtetutës, si dhe shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin paqësor të pronës së tyre, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si pasojë e mospërmbarimit (shih Aktgjykimin e 16 prillit 2014, KI187/13 *N. Jovanović*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme, GSK-AKP-A-001/12, të 8 majit 2012, dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011).
58. Prandaj, barra e mospërmbarimit dhe mosgjetjes së mekanizmave përkatës për përmbarimin e vendimeve të formës së prerë të KKPb-së, në rastin e parashtruesit të kërkesës, bie vetëm mbi AKP-në.

59. Prandaj, Gjykata rikujton se AKP-ja ka obligim që t'i përmbarojë vendimet e KKPK-së.
60. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm të KKPK-së, përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës

61. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
62. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës, përcakton:
 - 1) *E drejta e pronës është e garantuar.*
 - 2) *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
 - 3) *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (...)*

[...]
63. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parasheh:

“Çdo preson fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i vlerëson si të nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera.”
64. Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj, të 23 prillit 2012, ku theksoi se pasi që vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore bëhen të formës së prerë dhe *res judicata*, “parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar të drejtën e posedimit të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së” (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI104/10, Parashtrues *Dražo Arsić*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit GZ nr. 78/2010, të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, të 7 qershorit 2010, Aktgjykim i 10 majit 2012).
65. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, vendimi përkatës i KKPK-së u bë i formës së prerë dhe i detyrueshëm më 22 nëntor 2014.
66. Si e tillë, e drejta për posedimin e pronës në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për secilin parashtrues të kërkesës kishte filluar në këto data përkatëse.

67. Gjykata vëren se pavarësisht se vendimi i KPKK-së u bë i formës së prerë dhe detyrues, ai nuk u ekzekutua asnjëherë.
68. Gjykata konstaton se, si pasojë e mospërmbarimit të këtij vendimi, parashtruesit të kërkesës i është mohuar e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tij, në shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përfundim

69. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i vendimit të formës së prerë të KPKK-së, si në rastin e parashtruesit të kërkesës, përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në kombinim të nenit 6.1 të KEDNJ-së.
70. Gjykata gjithashtu konstaton se rrëzimi i vendimit të formës së prerë të KPKK-së përmes një vendimi administrativ nga Kuvendi Komunal i Pejës përbën shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.
71. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se si rezultat i mospërmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm, parashtruesi i kërkesës është privuar pa të drejtë nga prona e tij. Në këtë mënyrë është shkelur edhe e drejta e parashtruesit të kërkesës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e tij, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
72. Në fund, Gjykata konsideron se nuk duhet të merret më tej me pretendimet për shkelje të neneve 24 dhe 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 13 dhe 14 të KEDNJ-së, krahas kërkesës së parashtruesit për t'i dhënë kompensim monetar, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla janë konsumuar nga konstatimet e Gjykatës për shkelje të neneve 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës në kombinim me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së;
- IV. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.
- V. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktvendimin nr. 01-463-65203, i 14 majit 2015 të Kuvendit Komunal të Pejës.
- VI. TË KONSTATOJË se vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KKPK/D/R/230/2014, i 13 marsit 2014 duhet të përmbahet nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);
- VII. TA URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës së Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IX. TA PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Altay Suroy



Arta Rama-Hajrizi